

Kombet e Bashkuara

S/2017/95/Rev.

1



Këshilli i Sigurimit

Distr.: General

6 shkurt 2017

Origjinali:Anglisht

Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

I. Hyrje dhe prioritetet e Misionit

1. Ky raport paraqitet në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit [1244 \(1999\)](#), përmes së cilës Këshilli vendosi të themelojë Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), dhe kërkoi që unë të raportoj në intervale të rregullta për implementimin e mandatit të tij. Raporti mbulon aktivitetet e UNMIK-ut dhe zhvillimet që lidhen me të nga 16 tetori 2016 deri më 15 janar 2017.
2. Prioritetet e Misionit vazhdojnë të jenë promovimi i sigurisë, i stabilitetit dhe i respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë dhe në rajon. Për avancimin e objektivave të tij, UNMIK-u vazhdon angazhimin e tij konstruktiv me Prishtinën dhe me Beogradin, me të gjitha komunitetet në Kosovë dhe me akterët regjional e ndërkombëtarë. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Forca e Kosovës (KFOR) vazhdojnë të luajnë rolet e tyre brenda kornizës së Rezolutës së Këshillit të Sigurimit [1244 \(1999\)](#). Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) vazhdon praninë e tij në Kosovë në pajtim me deklaratën presidenciale të Këshillit të Sigurimit të datës 26 nëntor 2008 ([S/PRST/2008/44](#)) dhe me raportin tim të datës 24 nëntor 2008 ([S/2008/692](#)). Agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara punojnë ngushtë me këtë Mision.

II. Zhvillimet politike dhe të sigurisë

3. Gjatë periudhës raportuese, tensionet mes Prishtinës dhe Beogradit kanë arritur nivele shqetësuese, të cilat u manifestuan përmes deklaratave dhe akuzave të ashpra retorike lidhur me çështjet dhe ngjarjet e diskutueshme. Siç është raportuar më herët, miratimi i Ligjit të ri për Kompleksin Industrial Trepça nga Kuvendi i Kosovës më datën 8 tetor 2016, ka nxitur tensione tek palët e ndryshme politike dhe ishte shkas për protesta të fuqishme si nga Beogradi ashtu edhe nga komuniteti serb në Kosovë. Si rrjedhojë e kësaj, përfaqësuesit dhe zyrtarët serbë të Kosovës kanë pezulluar pjesëmarrjen e tyre në institucionet qeveritare.

4. Më datën 2 dhjetor, Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, dhe zyrtarët e tjerë qeveritarë, duke përfshirë ministrin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haki Demolli, morën pjesë në ceremoninë e hapjes së urës së Bisticës në komunën e Zveçanit me ftesë të KFOR-it, i cili kishte realizuar projektin e rehabilitimit të urës.

17-01779 (E) 060217
1701779

Please recycle 



Kjo nxiti reagim të shpejtë dhe të fuqishëm nga aktivistët lokalë serbë, të cilët bllokuan rrugën kryesore për në urë. Zyrtarët e Kosovës ia dolën që të arrijnë tek vendi i ceremonisë, duke shfrytëzuar një rrugë alternative. Më pastaj, përfaqësuesit serbë të Kosovës bojkotuan ceremoninë, dhe tre nga katër kryetarët e komunave veriore me shumicë serbe nxorën një komunikatë, ku akuzonin KFOR-in se ka vepruar në mënyrë joneutrale dhe se ka marrë rol politik, si dhe shpallën pezullimin e bashkëpunimit zyrtar mes komunave dhe KFOR-it.

5. Në kuadër të punëve ndërtimore për shndërrimin e rrugës Mbreti Petar në Mitrovicën Veriore në rrugë këmbësorësh, e cila ishte temë e diskutimeve të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian në Bruksel, është ndërtuar edhe një mur në pjesën e fundme jugore të rrugës mu përballë urës. Kjo nxiti dënime të rrepta nga ana e Prishtinës, me një retorikë përshkallëzuese ku kërkohej rrënimi i murit. Kompromisin e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian mes kryetarit të komunës së Mitrovicës së Veriut të atij të Mitrovicës së Jugut për zvogëlimin e lartësisë së murit Prishtina nuk e ka pranuar. Megjithatë, puna për zvogëlimin e lartësisë së murit ka filluar. Më 29 dhjetor, Kuvendi i Kosovës miratoi një rezolutë joobliguese për heqjen e murit. Rezoluta është më shumë deklaratë politike sesa një vendim ekzekutiv, dhe nuk jep udhëzime se si duhet të hiqet muri. Përkundër tensioneve të dukshme në nivel politik, brenda komunitetit të Mitrovicës së Veriut nuk vërehet ndonjë tension.

6. Më 4 janar 2017, udhëheqësi i partisë opozitare Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe ish-kryeministri, Ramush Haradinaj, është ndaluar nga autoritetet franceze në bazë të fletarrestit të lëshuar nga INTERPOL-i me kërkesë të Serbisë, lidhur me përfshirjen e tij të pretenduar në krimet e luftës të kryera në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Arrestimi nxiti reagime të ashpra si nga udhëheqësit politikë shqiptarë të Kosovës, ashtu edhe nga segmentet e publikut në përgjithësi. Më 10 janar, Serbia zyrtarisht kërkoi ekstradimin e z. Haradinajt nga Franca. Më 12 janar, gjykatat franceze përkohësisht e liruan z. Haradinajn, por ia morën pasaportën deri në marrjen e vendimit përfundimtar lidhur me çështjen.

7. Nga aspekti ndërkombëtar, tensioni mes Prishtinës dhe Beogradit u përshkallëzua edhe më tej kur Serbia hapi linjën e re hekurudhore Beograd-Mitrovicë e Veriut, me ç'rast treni dukshëm ishte dekoruar me flamurin serb dhe me frazën “Kosova është Serbi”, të përkthyer në shumë gjuhë. Më 14 janar, para arritjes së parë të trenit, që raportohet të mos jetë bashkërenduar me autoritetet qendrore të Kosovës, policia e Kosovës dërgoi njësinë speciale, ku ishin rreth 60 policë dhe 17 automjete të blinduara për të ndaluar dhe kontrolluar trenin pasi që të kalonte kufirin administrativ. Sipas udhëzimeve të Beogradit, treni

ndaloi para se të kalonte kufirin dhe më pas u kthye në Beograd. Me këtë rast, si Beogradi ashtu edhe Prishtina dolën me akuza ndaj palës tjetër për provokim të qëllimshëm të trazirave dhe të dhunës së mundshme. Insinuatat dhe gjuha luftënxitëse ngritën tensionin brenda opinionit publik si tek serbët e Kosovës ashtu edhe tek shqiptarët e Kosovës.

8. Brenda Kosovës, marrëdhëniet e tensionuara mes partive në pushtet dhe atyre opozitare, si dhe mes partive brenda koalicionit qeverisës kanë penguar përparimin rreth objektivave kryesore qeveritare. Aktivitetet legjislative të Kuvendit të Kosovës kanë qenë të ngadalshme apo plotësisht janë ndalur lidhur me disa çështje imediate strategjike, siç është ratifikimi i marrëveshjes për demarkacion apo shënim të kufirit me Malin e Zi.

Duke ia shtuar kësaj edhe përparimin e pamjaftueshëm në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, Bashkimi Evropian rrjedhimisht nuk ka qenë në gjendje të ecë përpara në heqjen e vizave Shengen për Kosovën.

9. Vdekja gjatë mbajtjes në paraburgim më 5 nëntor 2016 e anëtarit të partisë opozitare Vetëvendosje, Astrit Dehari, ka çuar në tensione politike dhe qytetare. z. Dehari mbahej në paraburgim në Prizren 68 ditë me akuzën për terrorizëm lidhur me sulmin me granatahedhës në objektin e Kuvendit të Kosovës më datën 4 gusht. Vetëvendosje deklaroi se Dehari ishte vrarë, me ç'rast janë mbajtur protestat paqësore në Prishtinë dhe Prizren, ku kërkohet hetimi i paanshëm dhe transparent për përcaktimin e shkaqeve të vdekjes. Pas rezultateve të autopsisë, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, deklaroi se shkak i vdekjes ishte asfiksia e vetëshkaktuar mekanike. Megjithatë, përfaqësuesi ligjor i familjes sfidoi validitetin e autopsisë. Më 22 nëntor, inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë ka pezulluar katër zyrtarë të qendrës së paraburgimit në Prizren për “shpërfillje të procedurave” lidhur me vdekjen e z. Deharit. Përkitazi me zhvillimet e datës 29 dhjetor, Prokurori Special ka ngritur aktakuzë për terrorizëm kundër katër aktivistëve të Vetëvendosjes lidhur me pretendimin se kanë gjuajtur me granatahedhës objektin e Kuvendit të Kosovës më datën 4 gusht.

10. Tensionet mes përfaqësuesve politikë të serbëve të Kosovës kanë qenë temë e kundërshtive politike mes degës së Lëvizjes Socialiste dhe të asaj të Partisë Progresiste Serbe të Iniciativës Qytetare Lista Serbe (Gradjanska Inicijativa Srpska Lista), ku dega e Lëvizjes Socialiste kërcënonte se do të ndjekë linjë të pavarur të politikave, duke përfshirë edhe rifillimin e pjesëmarrjes në aktivitete të qeverisë. Më 26 dhjetor, përfaqësuesit politikë të serbëve të Kosovës u takuan në Beograd me kryeministrin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Pas këtij takimi ata konfirmuan unitetin me partinë Iniciativa Qytetare Lista Serbe. Kjo parashihte edhe vazhdimin e bojkotit të aktiviteteve zyrtare të institucioneve të Kosovës.

11. Ekstremizmi i dhunshëm, radikalizimi dhe terrorizmi vazhduan të jenë kërcënim për sigurinë në Kosovë dhe regjion. Në nëntor, autoritetet ndaluan 19 persona, për të cilët dyshohej se po planifikonin sulm terrorist në Kosovë dhe në regjion nën urdhrat e militantëve të Kosovës që po luftojnë në Shtetin Islamik. Gjatë arrestimeve janë konfiskuar një numër armësh dhe mjetesh eksplozive. Më 30 nëntor Gjykata e Apelit vërtetoi dënimin e nëntë imamëve që akuzoheshin për rekrutimin e 70 personave për të përkrahur Shtetin Islamik në luftën që po zhvillohet në Republikën Arabe të Sirisë. Dënimet kanë qenë prej 4 deri në 18 vjet. Në dhjetor

autoritetet belge kanë arrestuar dy individë nga Kosova për pjesëmarrjen e dyshuar në aktivitete terroriste të lidhura me Shtetin Islamik.

12. Migrimi vazhdoi të paraqiste sfida në tërë regjionin. Mbyllja e korridorit ballkanik përmes ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Serbisë dhe Kroacisë, të cilën e shpallën si të mbyllur udhëheqësit evropianë në fillim të marsit, rezultoi me bllokim në Serbi të një numri të madh njerëzish që ishin në lëvizje. Së këndejmi, gjatë periudhës raportuese u shënuar rritje në numrin e personave që kalonin transit përmes Kosovës. Kështu, gjatë vitit 2016 në Kosovë janë ndaluar 307 persona, ky 76 syresh kanë ardhur vetëm gjatë dhjetorit. Trendi tregon se shumica e emigrantëve kanë hyrë në Kosovë përmes Shqipërisë me qëllimin për të vazhduar tutje. Azilkërkuesit janë trajtuar në përputhje me të drejtën ndërkombëtare humanitare,

duke përfshirë edhe regjistrimin, kontrollin mjekësor dhe ofrimin e banimit. Deri më sot, kapacitetet për administrimin e emigrantëve kanë qenë të mjaftueshme dhe i kanë plotësuar kërkesat.

13. Më 23 dhjetor, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për buxhet për vitin 2017, shuma e të cilit është mbi 2 miliardë euro. Buxheti ka shënuar rritje prej më shumë se 15 për qind krahasuar me atë të vitit 2016. Kjo rritje vjen si rezultat edhe e ngritjes së madhe të shpenzimeve kapitale në shumë prej 750 milionë euro. Gjasat janë të vogla që buxheti për shpenzime kapitale i vitit 2016 të realizohet plotësisht, ku shpenzimet deri në fillim të nëntorit kanë arritur shumën e përafërt prej 60% të ndarjeve buxhetore. Buxheti i vitit 2017 përfshin edhe ndarjen e 50 milionë eurove për skemat pensionale të veteranëve të luftës dhe invalidëve të luftës.

III. Kosova e veriut

14. Më 29 tetor, në praninë e Policisë së Kosovës, barrikada e fundit e mbetur e vendosur nga qytetarët është hequr vullnetarisht nga lagja etnikisht e përzier Mëhalla e Boshnjakëve në Mitrovicën Veriore. Gjatë ditës së njëjtë, një pengesë e betonit e njohur si “Sheshi Adem Jashari” është hequr nga e njëjta lagje.

15. Zyrat e regjistrimit civil, ku punojnë ish-punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë që tani janë integruar në sistemin e Kosovës, janë duke u hapur në të katër komunat e veriut. Sapo që të jenë plotësisht funksionale, pritet që këto zyra të lëshojnë dokumente publike, siç janë dokumentet e identifikimit personal.

16. Më 10 janar 2017, një granatë dore shpërtheu në zyrën e re të Qeverisë së Kosovës në Mitrovicë të Veriut, duke shkaktuar dëme materiale në objekt. Ky incident erdhi pas një incidenti të mëhershëm më 28 dhjetor 2016, me ç’rast ishte gjetur një granatë dore e pashpërthyer afër të njëjtit objekt, pas një vizite të paparalajmëruar të ministres së Kosovës përgjegjëse për dialogun teknik mes Beogradit dhe Prishtinës, Edita Tahiri.

IV. Normalizimi i marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës

17. Gjatë periudhës raportuese, është arritur përparim i caktuar në zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara brenda kornizës së dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian mes Beogradit dhe Prishtinës, posaçërisht në fushat e integrimi të gjyqësorit, lirisë së lëvizjes dhe të telekomunikimeve.

18. Më 30 nëntor, Beogradi dhe Prishtina u pajtuan për hapat përfundimtarë lidhur me zbatimin e marrëveshjes për integrimin e

gjqësorit. Kështu, u arrit pajtimi që vendimet, që më parë i kishin nxjerrë gjykatat e udhëhequra nga serbët në Kosovë, do të njiheshin, përveç nëse janë nxjerrë në mungesë, dhe që divizioni i Gjykatës së Apelit i Mitrovicës së Veriut do të kishte juridiksion mbi të gjitha 10 komunat me shumicë serbe. Më 13 nëntor u arrit edhe një marrëveshje tjetër për telekomunikacionin. Pas kërkesës së parashtruar nga Austria, Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit ia ndau Kosovës kodin +383. Përmes kësaj marrëveshjeje gjithashtu u konfirmua bartja e asetëve të kompanisë shtetërore serbe, Telekom Srbija, kompanisë degë të saj të sapoformuar, MTS, të regjistruar në Prishtinë, për të cilat nuk do të paguhet dogana, tatimet apo tarifat. Kjo bartje e asetëve do të përfundohet dhe regjistrohet në sistemin e kadastrit të Kosovës.

MTS-ja do të ofrojë shërbime plotësisht të licencuara të telefonisë fikse në Kosovë dhe do të merr autorizimin e përkohshëm për shërbime mobile.

19. Nuk është arritur ndonjë përparim i dukshëm në themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë, i cili është aspekti kryesor i marrëveshjeve të arritura brenda kornizës së dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian. Përveç kësaj, vonesat po vazhdojnë në zbatimin e marrëveshjes për lirinë e lëvizjes me automjete, duke përfshirë edhe dispozitën lidhur me mbulimin e ndërsjellë të emblemave në tabelat e regjistrimit, e cila fillimisht ishte paraparë të hyjë në fuqi më 15 nëntor. Është me rëndësi të theksohet se asnjë takim i nivelit të lartë brenda kornizës së dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian nuk është mbajtur që nga janari i vitit 2016.

V. Kthimet, pajtimi, marrëdhëniet mes komuniteteve dhe trashëgimia kulturore

20. Në vitin 2016, Zyra e Komisionarit të Lartë për Refugjatë (UNHCR) regjistroi gjithsej 582 kthime vullnetare në Kosovë nga ana e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë. Numri i të kthyerve vullnetarë që nga viti 2000 gjithsej është 27,286. UNHCR-ja vlerëson se në fund të dhjetorit 2016, gjithsej numri i personave të zhvendosur brenda vendit dhe që jetojnë në Kosovë ishte 16,557. Nga ky numër, 423 banonin në 29 strehimore kolektive. Në vitin 2016, UNHCR-ja u kishte ndihmuar 480 personave në marrjen e dokumentacionit civil.

21. Në vazhden e një tentimi për keqardhje lidhur me pengimin e kthimeve, Kuvendi Komunal i Suharekës më 31 tetor lëshoi një deklaratë, përmes së cilës “kushtëzohej kthimi në fshatin Mushtishtë i serbëve të Kosovës të zhvendosur brenda vendit me zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur, si dhe me kërkim të faljes nga Serbia dhe nga serbët vendorë të Kosovës për krimet e kryera gjatë konfliktit në vitin 1999”. Në një incident të ndarë më datën 1 dhjetor, Policia e Kosovës evakuoi 10 serbë dhe malazez të zhvendosur, të cilët po merrnin pjesë në një vizitë “Shko e shih” të lehtësuar nga komuna në komunën e Deçanit, pasi që protestuesit e kishin penguar vizitën me agresivitet, ku në mesin e tyre ishin edhe disa punonjës të komunës. Duhet të nënvizohet se Policia e Kosovës para vizitës kishte verifikuar se asnjë pjesëmarrës në vizitë nuk kishte dosje apo akuza penale. Në të dyja rastet aspekti kryesor ishte çështja e pazgjidhur e personave të zhdukur dhe uzurpimi i paligjshëm i pronës së personave të zhvendosur, duke ia shtuar kësaj edhe emocionet e manipuluar të

komunitetit pranues. Policia e Kosovës raporti për raste të sulmeve të rënda fizike në Mitrovicë dhe Viti, si dhe një numër rastesh të dëmtimeve të shtëpive të të kthyerve. Përgjegjësia kryesore për ruajtjen e rendit dhe ligjit dhe për sigurimin e të drejtës në kthim është e autoriteteve të Kosovës, të cilat duhet të sigurohen që këto incidente të mos jenë precedentë për pengimin sistematik të kthimeve. Si në rastin e Suharekës, ashtu edhe në atë të Deçanit, mungesa e reagimit publik institucional ka qenë zhgënjyese.

22. Më 28 nëntor 2016, më rastin e Ditës së Pavarësisë së Shqipërisë, e cila në Kosovë festohet si Dita e Flamurit Shqiptar, konsullata turke në Prizren pësoi dëmtime të vogla nga një sulm me koktejl mollotovi. Pesë personat që janë arrestuar lidhur me këtë sulm, deklaruan se ishin nxitur nga ofendimi i shkaktuar

nga vendosja e flamurit turk në Ditën e Flamurit Shqiptar, dhe se nuk ishin në dijeni se objekti ishte i konsullatës turke.

23. Misioni vazhdoi të monitorojë zhvillimet lidhur me avancimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore. Një aspekt shqetësues është refuzimi këmbëngulës i autoriteteve të Kosovës i kërkesës për leje ndërtimi për rindërtimin e kishës ortodokse serbe të Shën Nikollës, e cila gjendet brenda kompleksit të Manastirit të Krye-engjëjve në Prizren. Në një rast tjetër, individë të panjohur i ndërruan dryrin derës së kishës së papërfunduar të Krishtit Shpëtimtarit, në Prishtinë, duke ua penguar kështu qasjen zyrtarëve kishtarë. Në një incident tjetër, më 1 janar 2017, persona të panjohur ia vunë zjarrin kompleksit përkujtimor të Gazimestanit në veri të Prishtinës, duke dëmtuar derën kryesore dhe materialin që mbulonte dy arkivole. Kisha e Shën Nikollës gjithashtu është ankuar se Agjencia kundër korrupsionit e Kosovës, e cila mban me qira objektin e kishës, nuk ka paguar qiranë që nga qershori i vitit 2014, dhe se nuk i është përgjigjur asnjë kërkesë të saj për pagesë.

24. Janë shënuar gjithashtu edhe disa zhvillime pozitive, ku më të rëndësishmet kanë qenë renovimi i tri lokacioneve kulturore në komunën e Kamenicës në kuadër të projektit “Ndërtimi i mirëbesimit përmes mbrojtjes së kulturës në Kosovë”, të financuar nga Bashkimi Evropian dhe të zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP).

VI. Të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit

25. Numri i rasteve të pazgjidhura të personave të zhdukur mbetet 1,660. Më 10 nëntor 2016, kryetari Thaçi, së bashku me udhëheqësin e Komisionit për persona të zhdukur të Qeverisë së Kosovës, u takuan me përfaqësuesit e familjeve të shqiptarëve të zhdukur të Kosovës dhe të serbëve të Kosovës. Kjo ishte hera e parë që nga përfundimi i konfliktit në vitin 1999 që familjet e personave të zhdukur të të dyja komuniteteve u takuan së bashku në prani të institucioneve të Kosovës për të diskutuar gjetjen e zgjidhjes për çështjen. Pas takimit, familjet e serbëve të Kosovës emëruan përfaqësuesit e tyre në këtë Komision.

26. Më 16 nëntor, gërmimi në një lokacion të dyshuar për varrezë masive në Mitrovicën veriore përkohësisht është pezulluar për shkak të shqetësimeve për sigurinë e punëtorëve. Në një zhvillim tjetër më 30 dhjetor, përfaqësuesit e asociacioneve të familjarëve shqiptarë të Kosovës u mblodhën jashtë Kuvendit të Kosovës për t’ua tërhequr vëmendjen udhëheqësve politikë lidhur me çështjen e personave të zhdukur. Pasi që udhëheqësit politikë të Kosovës refuzuan t’i bashkohen tubimit, përfaqësuesit hyn me dhunë në objektin e Kuvendit. Situata u

qetësua kur kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, u takua me përfaqësuesit për t'i dëgjuar ankesat dhe shqetësimet e tyre.

27. Marrëveshja për shtetin nikoqir mes Holandës dhe Kosovës, përmes së cilës sigurohet baza ligjore që dhomat e specializuara të Kosovës t'i kryejnë procedurat në Holandë lidhur me pretendimet për krimet e bëra në Kosovë mes 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000, ka hyrë në fuqi më 1 janar 2017. Më 14 dhjetor 2016, shefja e Misionit të EULEX-it në Kosovë zyrtarisht emëroi Ekaterina Trendafilova si kryetare të parë të dhomave të specializuara për një mandat katërvjeçar.

28. Më 28 tetor, Zyra e Prokurorit Special të EULEX-it në Kosovë ngriti padi për krime të luftës kundër kryetarit të partisë opozitare Nisma për Kosovën, Fatmir Limaj. Më 15 nëntor, Gjykata e Apelit në Prishtinë shpalli vendimet e saj për dy raste të krimeve të luftës, të njohura si “Drenica 1” dhe “Drenica 2”. Gjykata e Apelit në vendimin e saj zvogëloi dënimin e ish-kryetarit të komunës së Skenderajt dhe ish-komandantit të UÇK-së, Sami Lushtaku, nga 12 vjet në 7 vjet heqje lirie. Ish-shëfi i shtabit të UÇK-së, Sylejman Selimi, është dënuar me 10 vjet burg, ndërsa i akuzuari i tretë, Jahir Demaku, është dënuar me 7 vjet heqje lirie. Për të akuzuarit e tjerë, Gjykata e Apelit mbështeti aktvendimin e gjykatës themelore në Mitrovicë.

29. Gjatë periudhës raportuese janë ndërmarrë një numër hetimesh dhe ndjekjesh penale të zyrtarëve të akuzuar për keqpërdorim të pozitës apo të autoritetit. Më 17 nëntor, Zyra e Prokurorisë Speciale e EULEX-it në Kosovë ka ngritur padi kundër 24 personave, duke përfshirë ish-kryetarin e komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku, si dhe zyrtarët e lartë të Ministrisë së Drejtësisë, punëtorët e Shërbimit Korrektues të Kosovës, si dhe punonjësit mjekësorë të Qendrës Klinike të Prishtinës. Në aktpadi pretendohet se të dyshuarit kanë favorizuar një numër të akuzuarish derisa ata mbaheshin në paraburgim gjatë gjykimit të rastit “Drenica” dhe kanë falsifikuar diagnoza mjekësore për t’ua mundësuar të akuzuarve të mbahen në spital, gjë që ua ka mundësuar atyre ikjen. Më 21 dhjetor në Vushtrri, pas një hetimi katërmujor, 59 policë të Kosovës janë akuzuar për korrupsion dhe keqpërdorim të detyrës. Nga ky numër, 20 policë janë mbajtur në paraburgim 30 ditë, 16 të tjerëve u është shqiptuar masa e burgut shtëpiak. Për 23 policët e mbetur hetimet ende vazhdojnë.

30. Më 27 tetor, gjatë operacionit të policisë së Kosovës të përkrahur nga EUROPOL-i, janë arrestuar 7 persona nën akuzë të kontrabandimit të emigrantëve. Më 9 nëntor, 10 persona janë arrestuar gjatë një operacioni kundër kontrabandës të realizuar nga Policia e Kosovës në komunën e Prishtinës, Gjilanit, Ferizajt dhe atë të Prizrenit. Misioni i EULEX-it ka shprehur zhgënjimin ndaj vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës të janarit 2017 për urdhërimin e rigjyimit të tre personave të akuzuar për përfshirje në trafikimin e organeve në vitin 2013 në rastin “Medicus”. Në mars të vitit 2016, Gjykata e Apelit kaishte konfirmuar dënimet e shqiptuara.

VII. Partneritetet dhe bashkëpunimi

31. Gjatë periudhës raportuese Përfaqësuesi im Special vazhdoi që të angazhohet konstruktivisht me udhëheqësinë politike në Prishtinë dhe Beograd.

32. UNMIK-u vazhdoi lehtësimin e ndërlidhjes mes autoriteteve të Kosovës dhe INTERPOL-it lidhur me ofrimin e funksioneve të rëndësishme ndërkombëtare në zbatimin e ligjit. Ky funksionalitet varet nga bashkëpunimi i autoriteteve të Kosovës dhe respektimi i rregullave dhe procedurave të punës së INTERPOL-it nga ana e tyre. Gjatë periudhës raportuese u miratuan procedurat e reja nga Ministria e Drejtësisë dhe Policia e Kosovës, të cilat mund të kenë ndikim negativ në këtë bashkëpunim. UNMIK-u vazhdoi bashkëpunimin me autoritetet e Kosovës dhe me palët e tjera me interes, sipas nevojës, në trajtimin e kësaj çështjeje.

33. UNMIK-u vazhdoi me ofrimin e shërbimeve të vërtetimit të dokumenteve. Mes datave 16 tetor dhe 15 dhjetor gjithsej janë vërtetuar 541 dokumente,

duke përfshirë 120 dokumente të gjendjes civile, 328 dokumente të pensionit, 80 dokumente për vijueshmërinë në shkollë dhe 13 diploma të shkollës së mesme.

34. Më 7 dhjetor për nder të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, UNMIK-u në bashkëpunim me OSBE-në, Këshillin e Evropës dhe Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë ka organizuar aktivitetin e quajtur “Ngrite zërin sot për të drejtat e dikujt”. Përfaqësuesi im Special, së bashku me udhëheqësit e organizatave partnere iu drejtuan pjesëmarrësve dhe theksuan fuqinë dhe rëndësinë e porosive të tyre në luftën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

VIII. Vlerësimet

35. Është për të ardhur keq që përkushtimi, si i Beogradit ashtu edhe i Prishtinës, për avancimin e dialogut duket se po venitet. Kjo po ndodh pjesërisht si rezultat i preokupimit me shqetësimet për politikën vendore. Humbja e dinamikës ngritë rrezikun që procesi i normalizimit, që është në interes të të dyja palëve, të ndalet dhe ndoshta edhe të shkoj prapa.

36. Jam i shqetësuar për tensionet dhe akuzat e ndërsjella në rritje, të cilat kanë karakterizuar marrëdhëniet mes Prishtinës dhe Beogradit gjatë tremujorit të fundit, posaçërisht duke ditur se kjo ka ndodhur në kohën e ngritjeve të tensioneve etnike dhe retorikës së intensifikuar politike në regjion. Së këndejmi, i ftoj udhëheqësit e të dyja palëve që të kenë logjikë të shëndoshë dhe maturi më të madhe në ushtrimin e pozitave të tyre publike, t’i shmangen gjuhës së urrejtjes dhe të avancojnë pozitave të tyre vetëm me mjete paqësore dhe përmes dialogut të përgjegjshëm. Posaçërisht duhet të theksohet tendenca se zmadhimi i çështjeve të vogla në konteste të mëdha për qëllime të përparësive taktike apo të përfitimeve të ngushta ka kontribuar në përkeqësimin e marrëdhënieve mes Beogradit e Prishtinës.

37. Tek disa udhëheqës shoh shembuj të përkushtimit, guximit dhe vizionit të sinqertë për një ardhme më të mirë ku nuk do të ketë qasje të humbësit dhe fituesit, e cila nuk merr parasysh interesat reale të qytetarëve që u shërbejnë. Shembuj pozitivë të udhëheqjes shoh në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe shpresoj se të njëjtit do të përsëriten dhe do të bëhen më të shpeshtë gjatë vitit që po vjen.

38. Ftoj të dyja palët që t’i respektojnë marrëveshjet tanimë të arritura në kuadër të procesit të dialogut të lehtësuar nga BE-ja dhe që këtë ta bëjnë me vullnet të mirë dhe pa vonesa. Dua t’i përkujtoj udhëheqësit se asnjë përparim nuk është i pakthyesëm, dhe nëse proceset nuk shkojnë përpara apo nëse nuk rezultojnë me përmirësime të dukshme që priten nga popullata, ekziston mundësia e shkuarjes prapa që mund të jetë e rrezikshme.

39. Derisa emocionet e paskonfliktit gjithmonë duhet të merren parasysh dhe duhet të sigurohen forume të efektshme për trajtimin e humbjeve dhe shqetësimeve të lidhura me konfliktin, e drejta për kthim të sigurt dhe të dinjitetshëm është themelore dhe e pacenueshme. Kombet e Bashkuara mbasin të gatshme për përkrahjen e kthimeve të sigurta, pajtimit dhe për zgjidhjen e pasojave të vështira të konfliktit në Kosovë.

40. Është thelbësore që institucionet e Kosovës t'i respektojnë kushtet operationale të INTERPOL-it dhe rrjedhimisht të ripërtërijnë bashkëpunimin e tyre të plotë me UNMIK-un dhe me Zyrën e tij për ndërlidhje me INTERPOL-in për të siguruar angazhim të efektshëm në përpjekjet për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare. Respektimi i rregullave dhe procedurave operationale të INTERPOL-it është esencial për administrimin e drejtësisë.

41. UNMIK-u vazhdon të shkojë drejt një qasjeje më të fokusuar në zbatimin e mandatit të tij me qëllim të krijimit të ndikimit pozitiv në gjendjen delikate në Kosovë, posaçërisht përmes ndërmjetësimit, lehtësimit dhe përkrahjes së komuniteteve. Dua ta shfrytëzoj rastin për të ritheksuar rëndësinë e sigurimit që UNMIK-u t'i ketë resurset e duhura për trajtimin e sfidave të tanishme dhe atyre që mund të dalin, duke përfshirë procesin e brishtë të pajtimit dhe kërcënimin gjithnjë në ndryshim të ekstremizmit të dhunshëm. Misioni sipas konfigurimit të tij të tanishëm është mirë i përshtatur për t'iu përgjigjur sfidave në terren. Unë do të vazhdoj së siguruari që këto resurse të zbatohen në mënyrën më të efektshme dhe optimale.

42. Jam i inkurajuar nga angazhimi i vazhdueshëm konstruktiv i palëve me Përfaqësuesin tim Special, Zahir Tanin. Ai është në dispozicion për ndërmjetësim në zgjidhjen paqësore të kontesteve dhe keqkuptimeve.

43. Dua të përfundojë duke ua shprehur falënderimet e mia partnerëve afatgjatë të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, duke përfshirë KFOR-in, Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior, Bashkimin Evropian dhe OSBE-në, si dhe agjencive, fondeve dhe programeve të Kombeve të Bashkuara për përkrahjen dhe bashkëpunimin e tyre me UNMIK-un.

Aneksi I

Raporti i Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, mbi aktivitetet e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë nga 16 tetori 2016 deri më 15 janar 2017

1. **Përmbledhje**

Gjatë kësaj periudhe janë shqiptuar disa aktgjykime lidhur me krimet e luftës, krimin e organizuar, korrupsionin dhe krime të tjera të rënda. Gjykata e Apelit miratoi aktgjykimet në lëndët e krimeve të luftës “Drenica I” dhe “Drenica II”, duke ndryshuar aktgjykimet e shkallës së parë kundër disa të pandehurve dhe duke konfirmuar dënimet kundër të tjerëve. Gjykata e Apelit po ashtu miratoi një aktgjykim në një lëndë që lidhej me Ministrinë e Shëndetësisë kundër shtatë të pandehurve, duke e kthyer lëndën në gjykatën themelore të Prishtinës për rigjykim. Gjykata themelore në Prizren dënoi gjashtë të pandehur për mashtrim, për legalizim të përmbajtjes së rreme dhe për uzurpim të paligjshëm të pasurisë në një pjesë historike të Prishtinës. Gjykata themelore në Ferizaj dënoi një ish polic të Kosovës për keqpërdorim të pozitës zyrtare, për pranim të ryshfetit, për ushtrim të ndikimit, për ofrimin e ndihmës kryerësve dhe për mosraportim të veprave penale. Prokuroria Speciale e Kosovës urdhëroi gjykatën themelore të Prishtinës të ndërpresë hetimet për korrupsionin e pretenduar brenda EULEX-it. Përveç kësaj, u ngritën disa aktakuza, duke përfshirë rastin e “Arratisjes nga spitali” si dhe rastin lidhur me përvetësimin e pronave shoqërore (lënda “Azem Sylja dhe të tjerët.”).

Pas integritit të grupit të parë prej 32 personave nga stafi administrativ i ish Ministrisë të Punëve të Brendshme të Serbisë, u hapën zyrat e regjistrimit civil të Kosovës dhe zyrtarisht filluan t’u ofrojnë shërbime njerëzve që jetonin në katër komunat veriore.

Pas vdekjes së aktivistit të Vetëvendosjes Astrit Dehari në paraburgim, EULEX-i monitoroi hetimin e Shërbimit korrektues të Kosovës, dhe inicioi një program trajnimi bazik mjekësor për stafin e burgut të sigurisë lartë dhe për qendrën e paraburgimit në Prishtinë. Ky trajnim do t’u ofrohet edhe stafit në objekte të tjera të Shërbimit korrektues të Kosovës. EULEX-i gjithashtu ka mbajtur trajnime për negociata, duke përfshirë edhe menaxhimin e incidenteve të rënda për drejtorët e Shërbimit korrektues të Kosovës, që ata t’i avancojnë teknikat dhe aftësitë e

tyre në këtë fushë.

S/2017/95/Rev.1

Më 7 dhjetor u takua Bordi i përbashkët koordinues për sundimin re ligjit, për të vlerësuar progresin në sundimin e ligjit, dhe me këtë rast nxori një raport kompakt të progresit duke mbuluar periudhën prej gushtit 2015 deri në qershor 2016. Ky kompakt i ri, i cili pasqyron përgjegjësitë e shtuara të institucioneve të Kosovës, u nënshkrua në mes të EULEX-it, Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian /Zyra e Bashkimit Evropian.

2. Aktivitetet e EULEX-it

2.1 Ekzekutivi

Krimet e luftës

Në tetor, një trup gjykues me një gjyqtar vendor dhe dy gjyqtarë të EULEX-it, filluan seancën e apelit në lëndën ku gjykata themelore në Mitrovicë e kishte shpall Ivanoviçin fajtor për krime lufte kundër popullatës civile, dhe e kishte dënuar me nëntë vite burgim (lënda “Oliver Ivanoviç dhe të tjerët”).

Më 24 tetor, një trup gjykues me një gjyqtar vendor dhe dy gjyqtarë të EULEX-it shpallën aktgjykimin lidhur me ankesat e mbrojtjes dhe prokurorit kundër aktgjykimit në lëndën “Drenica II”. Gjykata e apelit e uli dënimin për një të pandehur nga tetë në shtatë vite, për një të pandehur tjetër nga shtatë në gjashtë vite e gjashtë muaj, dhe për dy të pandehur tjerë nga shtatë në gjashtë vite burgim. Për gjashtë të pandehur të tjerë u konfirmuan dënimet me tri vite burgim.

Më 7 nëntor, Ministria e Drejtësisë e Malit të Zi miratoi kërkesën e Prokurorisë Speciale të Kosovës që në Kosovë të ekstradojë një qytetar, i cili kërkohej për krime lufte të kryera në këtë vend kundër popullatës civile sipas Kodit Penal të ish Republikës Federale të Jugosllavisë. Personi në fjalë është në paraburgim deri më 27 janar 2017.

Më 15 nëntor, një trup gjykues i përbërë nga një gjyqtar vendor dhe dy gjyqtarë të EULEX-it, vendosën për ankesën e mbrojtjes kundër aktgjykimit të lëshuar nga gjykata themelore e Mitrovicës në lëndën “Drenica I”. Gjykate e apelit e ndryshoi aktgjykimin lidhur me një të pandehur duke e ulur dënimin e tij prej 12 në 7 vite burgim. Një i pandehur tjetër u dënua me pesë vite, një u lirua dhe aktgjykimet tjera u konfirmuan.

Më 9 dhjetor një i dyshuar në një rast që lidhej me krime lufte kundër popullatës civile gjatë marsit të vitit 1999 në Fushë Kosovë, u ekstradua nga Bosnja dhe Hercegovina, mbi bazën e një letërreshtimi ndërkombëtar të lëshuar në emër të një prokurori të EULEX-it. Të pandehurit ju caktua masa e paraburgimit.

Krimi i organizuar dhe korrupsioni

Në tetor, një trup gjykues i përbërë nga një gjyqtar

vendor dhe dy gjyqtarë të EULEX-it në gjykatën themelore të Ferizajt, dënuan një ish polic të Kosovës për keqpërdorim të pozitës zyrtare, për pranim të ryshfetit, për ushtrim të ndikimit, për ofrimin e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprës dhe për mosraportim të veprave penale. Të pandehurit ju shqiptua një dënim i përgjithshëm me shtatë vite burgim, me ndalesën e mbajtjes së çfarëdo posti zyrtar për një periudhë prej pesë vitesh pas lirimit.

Më 21 tetor, një trup gjykues i përbërë nga një gjyqtar vendor dhe dy gjyqtarë të EULEX-it, në gjykatën themelore të Prizrenit morën aktgjykimin për një rast penal ku ishin të përfshirë nëntë të pandehur, që kishte të bënte me uzurpim të paligjshëm të pronës në një pjesë historike të Prishtinës, ku u ndërtua një objekt modern pa leje ndërtimi. Gjashtë nga të pandehurit trupi gjykues i shpalli fajtor për mashtrim, për legalizim të përmbajtjes së rreme dhe për uzurpim të paligjshëm të pasurisë, dhe dy të pandehur i dënoi me burg efektiv prej 2 vitesh dhe katër të tjerë me 1 vit e 10 muaj burgim. Ekzekutimi i dënimit me burg u pezullua për dy vjet. Trupi gjykues hodhi poshtë akuzat për marrjen e vendimeve të paligjshme gjyqësore, për abuzim të autoritetit zyrtar dhe për mashtrim kundër tre të akuzuarve të tjerë meqë akuzat kalonin afatet e parashkrimit. Të gjithë të pandehurit u liruan nga akuzat për krim të organizuar.

Më 25 tetor, në Prokurorinë Speciale të Kosovës një prokuror i EULEX-it parashtri dy aktakuzë në rastin “Azem Sylja dhe të tjerët.” Në aktakuzën e parë, 22 të pandehur u akuzuan me 46 pika të aktakuzës për vepra penale, duke përfshirë krimin e organizuar, larjen e parave, pranimin e ryshfetit, mashtrimin e rëndë, mashtrimin në detyrë, marrjen e vendimeve të paligjshme gjyqësore, keqpërdorimin e pozitës zyrtare, legalizimin e përmbajtjes së rreme dhe shmangien nga tatimi. Në aktakuzën e dytë, 17 të pandehur u akuzuan për larje të parave.

Më 7 nëntor, Prokuroria Speciale e Kosovës paraqiti vendimin në gjykatën themelore të Prishtinës për ndërprerjen e hetimit për korrupsionin e pretenduar brenda EULEX-it (rasti “Hermes”). Akuza për pranim të ryshfetit kundër një të pandehuri dhe akuzat për dhënie të ryshfetit kundër tre të pandehurve të tjerë u refuzuan. Materialet dëshmuese treguan se ish gjyqtari i EULEX-it, Francesco Florit, as nuk kërkoi as nuk pranoi çfarëdo forme të ryshfetit, dhe as nuk pranoi ndonjë premtim për ryshfet. Dëshmitë po ashtu vërtetuan se tre të pandehurit e tjerë nuk e kryen veprën penale të dhënies së ryshfetit.

Më 17 nëntor, një prokuror i EULEX-it parashtroi aktakuzë për një rast që, ndër të tjera, kishte të bënte me keqpërdorim të pozitës zyrtare apo të pushtetit, mundësim të arratisjes së personave të privuar nga liria, kërcënim gjatë procedurës penale, pjesëmarrje në një grup të organizuar kriminal apo organizim i një grupi të tillë (rasti i “arratisjes nga spitali”) kundër 24 të pandehurve, duke përfshirë tre persona të dënuar më parë për krime lufte dhe 11 pjesëtarë të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Më 9 dhjetor, një prokuror i EULEX-it parashtroi akuzë kundër një të pandehuri për larje parash. Kjo aktakuzë është e lidhur me aktakuzën e parashtruar më 3 mars 2016 kundër 23 të pandehurve të tjerë në rastin “Toka 4”, lidhur me 36.45 hektarë tokë në pronësi shoqërore, që u fituan përmes një vendimi të paligjshëm gjyqësor.

Më 13 dhjetor, një trup gjykues i përbërë nga një gjyqtar vendor dhe dy gjyqtarë të EULEX-it, miratoi në Gjykatën e Apelit një aktgjykim në një rast që lidhej me Ministrinë e Shëndetësisë kundër shtatë të pandehurve. Ata u akuzuan për keqpërdorim të pozitës zyrtare apo të pushtetit, për keqtrajtim në shtrimin e detyrave zyrtare, për pranim të ryshfetit, për shmangie nga tatimi dhe për pengim të dëshmisë. Trupi gjykues pjesërisht e miratoi ankesën e parashtruar nga Prokuroria Speciale e Kosovës, duke e anuluar aktgjykimin e shkallës së parë për disa pika specifike të aktakuzës dhe duke e kthyer lëndën në gjykatën themelore të Prishtinës për rigjykim.

Më 30 dhjetor, një trup gjykues i përbërë nga dy gjyqtarë vendorë dhe një gjyqtar i EULEX-it, shpalli aktgjykimin e tij në Gjykatën Supreme, duke i anuluar aktgjykimet paraprake të gjykatës themelore të Prishtinës dhe të Gjykatës së Apelit, me të cilët tre të pandehur ishin shpallur fajtor për trafikim me qenie njerëzore dhe krim të organizuar në rastin “Medicus”, që ka të bëjë me heqjen e veshkave për transplantim në Klinikën Medicus në vitin 2008. Gjykata Supreme e ktheu lëndën në gjykatën themelore në Prishtinë për rigjykim, mbi bazën e dy shkeljeve procedurale. Gjyqtari i EULEX-it paraqiti mendim kundërshtues duke argumentuar se nuk ka arsye për anulim të aktgjykimeve të gjykatës themelore të Prishtinës dhe të Gjykatës së Apelit dhe për urdhërim të rigjyimit.

Krime tjera të rënda

Në tetor, një trup gjykues në Gjykatën e Apelit i përbërë nga

një gjyqtar vendor dhe dy gjyqtarë të EULEX-it, pjesërisht e miratuan ankesën e mbrojtjes kundër aktgjykimit të gjykatës themelore të datës 23 tetor 2015, në një rast ku të përfshirë ishin një i pandehur për një sulm në kolonën e automjeteve të EULEX-it afër Zubin Potokut më 3 prill 2012. Akuza për dëme të pasurisë së luajtshme u refuzua për shkak të afatit të parashkrimit. Gjykata e apelit e dënoi të pandehurin për veprat penale të rrezikimit të personelit, për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare dhe për sulmim të personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, të kryer në bashkëveprim dhe në vazhdimësi. Gjykata e Apelit e konfirmoi dënimin me një vit e dhjetë muaj burgim, të pezulluar për 4 vite.

Më 21 nëntor, një trup gjykues me gjyqtarë të EULEX-it në gjykatën themelore të Mitrovicës, e shpalli aktgjykimin kundër dy të pandehurve në lëndën penale lidhur me ngjarjet që çuan në vrasjen e policit të Kosovës, Enver Zymberi në vitin 2011. Të pandehurit u dënuan për veprën penale të pjesëmarrjes në një grup që pengonte personat zyrtarë në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare. Një i pandehur u dënua me 18 muaj burgim, të pezulluar për 3 vite, kurse i pandehuri tjetër u dënua me 2 vite burgim, të pezulluar për 4 vite.

Më 25 nëntor, një prokuror i EULEX-it parashtrori aktakuzë kundër një të dyshuari të akuzuar për vrasje të rëndë dhe tentim për vrasje të rëndë, në rastin vrasjes së një viktime dhe tentimin për vrasje të rëndë të një polici të Kosovës në City Club në Pejë në vitin 2010 (lënda e “City Club”).

Më 19 dhjetor, një trup gjykues me një gjyqtar vendor dhe dy gjyqtarë të EULEX-it, morën aktgjykim në Gjykatën e Apelit në lëndën penale kundër një të pandehuri të akuzuar për fshehtësinë e procedurës, dhe tentimin për pengim të dëshmisë apo procedurës zyrtare. Trupi gjykues e shpalli të pafajshëm të pandehurin dhe e vërtetoi shfajësimin nga gjykata themelore në Mitrovicë.

Instituti i mjekësisë ligjore

Ekspertët e mjekësisë ligjore të EULEX-it, dorëzuan në Institutin e Kosovës për mjekësi ligjore shtatë grumbuj të mbetjeve mortore, bënë një zhvarrosje dhe identifikuan mbetjet mortore të gjashtë individëve, dy nga të cilët ishin persona të zhdukur. Ata po ashtu bënë vlerësimin e lokacioneve në Glogoc, Kaçanik dhe Leposaviç, dhe vazhduan vlerësimin e lokacionit në Kizhevak në kompleksin e minierës në Rudnicë në Serbi, që u ndërpre më 2 dhjetor në periudhën e dimrit deri në pranverë 2017. Ekspertët e mjekësisë

ligjore të EULEX-it vazhduan punën në kryerjen e autopsive dhe ekzaminimeve klinike të rasteve të pakryera. U bënë përgatitjet për nisjen e një trajnimit online për antropologjinë e mjekësisë ligjore për dy mjekë vendorë, i paraparë të mbahet në fillim të 2017.

Të drejta pronësore

Paneli i ankesave i Agjencisë Kosovare të Pronës ka pranuar tri ankesa të reja dhe ka marrë vendim për 22 ankesa, nga 342 ankesa në pritje për t'u vendosur nga paneli.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështje të privatizimit mori 296 vendime për lëndët e trupit gjykues të shkallës së parë, dhe përmbylli 67 lëndë në nivelin e panelit të apelit.

Integrimi i gjyqësorit

Pas marrëveshjes së arritur në kuadër të kornizës së dialogut të mundësuar nga Bashkimi Evropian në mes të Kosovës dhe Serbisë, mbi hapat e fundit për implementimin e Marrëveshjes për drejtësinë, integrimi i gjyqtarëve, i prokurorëve dhe i stafit gjyqësor në gjyqësorin e Kosovës ishte paraparë të realizohet në janar të vitit 2017.

Policia ekzekutive

Më 26 dhe 27 tetor, EULEX-i ka mbajtur trajnime për Njësinë koordinuese të Policisë së Kosovës për zbatimin e të drejtës ndërkombëtare mbi bashkëpunimin ndërkombëtarë policor në luftën kundër kontrabandimit të mallrave të paligjshme. Ky trajnim u përqendrua në përfshirjen e kësaj Njësie, në mënyrat si ajo mund të bëhet pikë kontaktuese për shkëmbimin e informacioneve në mes të autoriteteve ligjzbatuese në Kosovë, dhe implementimin e qasjeve të integritit me EUROPOL-in dhe INTERPOL-in.

Nga 21 deri më 24 nëntor, EULEX-i ka mbajtur një punëtori trajnuese për bashkëpunimin policor ndërkombëtar, për avancimin e punës së Njesisë koordinuese të Policisë së Kosovës për zbatimin e të drejtës ndërkombëtare, dhe për ngritjen e vetëdijes së njësive hetuese të specializuara të policisë së Kosovës për mënyrat e përfitimit nga instrumentet dhe kanalet e ndryshme të bashkëpunimit policor ndërkombëtarë.

Nga 21 deri më 26 nëntor, EULEX-i morri pjesë në një manovër të përbashkët Silver Sabre 2016 -2 të KFOR-it, që ka të bëjë me taktikat dhe veprimet në planifikimin dhe ekzekutimin e simulimeve të trazirave qytetare dhe katastrofave natyrore. Synimi i kësaj manovre ishte të përmirësojë edhe më shumë shkathtësitë e ofruesve kryesorë të sigurisë në Kosovë për bashkëpunim dhe koordinim.

2.2 Fuqizimi

Me integrimin e grupit të parë prej 32 pjesëtarëve të stafit administrativ të ish Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, u hapën zyrtarisht zyrat e regjistrimit civil dhe filluan ofrimin e shërbimeve për njerëzit që jetojnë në katër komunat veriore, bazuar në Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013.

Bordi i përbashkët koordinues për sundimin e ligjit u takua më 7 dhjetor për të vlerësuar përparimin në fushën e sundimit të ligjit, duke nxjerrë Raportin Kompakt të Progresit që mbulon periudhën prej gushtit 2015 deri në qershor 2016. Kjo shënon një hap të rëndësishëm sepse ofroi një mundësi për të ardhmen. U nënshkrua një Kompakt i ri në mes të EULEX-it, Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Zyrës së Bashkimit Evropian/Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian, që paraqet përgjegjësi të shtuara për institucionet e Kosovës.

Vlerësimi i EULEX-it ishte se Divizioni i njësive të specializuara të Policisë së Kosovës ka reaguar shkëlqyeshëm, në nivel të standardeve të Bashkimit Evropian, në të gjitha mënyrat e intervenimit, duke u radhitur nga sigurimi i VIP-ave, operacioneve për kontrollimin e turmave komplekse dhe trazirave deri tek arrestimet e nivelit të lartë dhe operacionet e improvizuara të mjeteve eksplozive. Njësia e trashëgimisë religjioze dhe kulturore ka vepruar në nivel të kënaqshëm. Edhe pse nuk ka pas tregues të kërcënimeve të drejtpërdrejta kundër objekteve religjioze, ka nevojë të vazhdueshme për të siguruar objektet e ndjeshme religjioze. EULEX-i e siguroi draftin përfundimtar të instalimeve të kamerave në objektet religjioze dhe ato të trashëgimisë kulturore, si pjesë e projektit të UNDP-së të sponsorizuar nga Bashkimi Evropian për krijimin e besimit përmes mbrojtjes kulturore.

Më 5 nëntor, aktivisti i Vetëvendosjes Astrit Dehari vdiq në paraburgim. Ai kishte qenë në paraburgim që nga gushti, pasi ishte arrestuar me dyshimin për terrorizëm për gjoja hedhjen e një mjeti shpërthyes në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës. Më 18 nëntor, kryeprokurori i Prizrenit e paraqiti raportin e mjekësisë ligjore dhe konfirmoi se Dehari kishte bërë vetëvrasje, pa ndonjë përfshirje të palëve të treta. Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë konstatoi disa shpërfillje procedurale nga ana e stafit të Shërbimit korrektues të Kosovës. Është bërë një hetim i brendshëm nga Shërbimi korrektues i Kosovës. Si masë paraprake është suspenduar një zyrtar i Shërbimit korrektues të Kosovës, dy mbikëqyrës dhe ushtruesi i detyrës së drejtorit të qendrës së paraburgimit në Prizren. EULEX-i e ka monitoruar Shërbimin korrektues të Kosovës nga faza fillestare e hetimit si dhe inspektimin e kryer nga Inspektorati.

EULEX-i filloi të ofrojë trajnime bazike mjekësore për 54 pjesëtarë të stafit në burgun e sigurisë së lartë dhe qendrën e paraburgimit në Prishtinë, që do të vazhdojë në të gjitha qendrat tjera të Shërbimit korrektues të Kosovës, për stafin që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me të burgosurit dhe janë të parët që reagojnë në rast të ndonjë urgjence. Trajnime për negociata u mbajtën me drejtorët e Shërbimit korrektues të Kosovës për menaxhimin e incidenteve të rënda, me qëllimi të avancimit të teknikave të negociatave për të trajtuar në mënyrë të suksesshme incidentet siç janë bllokimi i qelive, ngjitja në objekte të larta, grevat e urisë, kërcënimet për vetëvrasje, marrja peng, rezistenca kolektive, demonstratat dhe trazirat.

EULEX-i ka mbajtur punëtori për identifikimin, incizimin,

hetimin dhe ndjekjen penale të mundshme për krimet e urrejtjes, dhe një punëtori për shfrytëzimin efektiv të kapaciteteve të mjekësisë ligjore lidhur me hetimet e dhunës seksuale dhe dhunës në baza gjinore. Ndonëse të dy punëtoritë kishin një fokus tematik, të dyja trajtuan çështje që kanë të bëjnë me ndërveprueshmërinë e institucioneve relevante të Kosovës, duke përfshirë policinë, prokurorët, gjykatat dhe shoqërinë civile.

Misioni vazhdoi aktivitetet e veta monitoruese lidhur me lëndët që u dorëzohen autoriteteve vendore.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës miratoi amendamentet në Rregulloren mbi procedurat e zgjedhjeve, emërtimet, vlerësimet, suspendimin dhe shkarkimin e kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve kryesues. Këshilli zbatoi këshillën e EULEX-it që vlerësimi fillestar i kandidatëve për kryetarë të gjykatave të bëhet nga një komision vlerësues, duke përjashtu anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës që shërbejnë si gjyqtarë në gjykatën përkatëse. EULEX-i ka zhvilluar bisedime të rregullta me kryesuesin e Këshillit dhe me komisionin për çështje normative, për projektligjin mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe vendimi për Rregulloren mbi transferimin dhe caktimin e gjyqtarëve u miratua nga Këshilli, duke i inkorporuar komentet e EULEX-it.

Policia e Kosovës publikoi vlerësimin e saj të dytë për kërcënimin nga krimi i rëndë dhe krimi i organizuar. EULEX-i këtë e konsideron si një dokument bazë solid për identifikimin e tendencave aktuale dhe atyre të ardhshme të krimeve të rënda të organizuara brenda Kosovës. U përfundua Strategjia e policimit në komunitet dhe plani i veprimit i Policisë së Kosovës 2017 -2021, me pjesëmarrës nga Policia e Kosovës, OSBE-ja, Programi i asistencës për trajnim mbi hetimet penale ndërkombëtarë, UNDP-ja, EULEX-i dhe pjesëtarë nga komuniteti Islam. Ndonëse besimi i popullatës në Policinë e Kosovës është në rritje, akoma kemi mungesë të arsimimit dhe mungesë të materialeve për sa i përket zbatimit të strategjisë në praktikë.

Aneksi II

Dhomat e specializuara dhe Zyra e prokurorit të specializuar

Më 21 nëntor 2016, Mbretëria e Holandës e ratifikoi Marrëveshjen në mes Holandës dhe Kosovës. Marrëveshja hyri në fuqi më 1 janar 2017, duke siguruar bazën ligjore për zhvillimin e aktiviteteteve gjyqësore në Holandë.

Më 14 dhjetor 2016, pas rekomandimeve të panelit të pavarur përzgjedhës, gjyqtarja Ekaterina Trendafilova u emërua kryetare e dhomave të specializuara nga shefja e Misionit të EULEX-it. Kryetarja e morri detyrën më 12 janar 2017.

Zyra e prokurorit të specializuar vazhdoi punën e grupit veprues të Bashkimit Evropian për hetime speciale pa ndonjë vështirësi, dhe vazhdon të angazhohet me individë, me palët e dëmtuara dhe me grupet për mbrojtjen e viktimave, për të mbledhur dëshmi dhe informacione relevante për hetimet. Ndonëse Zyrës së prokurorit të specializuar i është ofruar ndihmë e kënaqshme nga autoritetet gjyqësore dhe ligjzbatuese në Prishtinë dhe Beograd, madje edhe pas periudhës raportuese, prokurori i specializuar pret ndihmë edhe më të madhe me ndërmarrjen e hapave dhe intensitetin e punës në Zyrën e prokurorit të specializuar.

Prokurori i specializuar ka shtuar përpjekjet në terren me synimin për të shpjeguar rolin dhe përgjegjësitë e Zyrës së porsaformuar të prokurorit të specializuar. Prokurori i specializuar vizitoi Prishtinën dhe Beogradin gjatë periudhës raportuese. Gjatë udhëtimit, prokurori i specializuar e përsëriti zotimin e tij se do të zbatojë hetim të pavarur dhe të paanshëm, të udhëhequr vetëm nga ligji, dhe të arrijë rezultate që janë legjitime dhe ata të perceptohen si legjitime nga ata të cilëve këto rezultate do t'u përkasin.

Aneksi III**Përbërja dhe forca e komponentës së policisë të Misionit të
Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë**

(nga 15 janari 2017)


<i>Shteti</i>	<i>Numri</i>
Austria	1
Bullgaria	1
Estonia	1
Gjermania	2 ^a
Hungaria	1
Italia	1
Federata Ruse	1
Gjithsej	8

^a Një polic me kontratë të Kombeve të Bashkuara.**Përbërja dhe forca e komponentës ndërlidhëse ushtarake të Misionit të
Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë**

(nga 15 janari 2017)

<i>Shteti</i>	<i>Numri</i>
Cekia	2
Polonia	2 ^a
Republika e Moldavisë	1
Rumunia	1
Turqia	1
Ukraina	2
Gjithsej	9

^a Një polic me kontratë të Kombeve të Bashkuara.



Map No. 4133 Rev. 86 UNITED NATIONS
January 2017 (Colour)

Department of Field Support
Geospatial Information Section (formerly Cartographic Section)

